

NË KËTË NUMËR

- U ZHVILLUA TRYEZA E RRUMBULLAKËT ME TEMË: "EKSPERIENCA SLOVENE NË TREGUN E SIGURIMEVE".
- ZHVILLON PUNIMET FORUMI ME TEMË "EDUKIMI FINANCIAR PËR PËRFSHIRJEN FINANCIARE"
- ZHVILLIMET KRYESORE TË TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR - MAJ 2018
- STAFI I SIGMA INTERALBANIAN VIG DHURON GJAK PËR FËMIJËT TALASEMIKË.
- ZHVILLOHET NE TIRANE "UNIQA INTERNATIONAL FORUM 2018".

Promovojmë
praktikat dhe
standartet më të
larta në fushën
e sigurimeve,
në mbrojtje të
interesave të
konsumatorëve.



U ZHVILLUA TRYEZA E RRUMBULLAKËT ME TEMË: "EKSPERIENCA SLOVENE NË TREGUN E SIGURIMEVE".

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën Sllovene të Sigurimeve organizuan me 13 Qershor 2018 në ambientet e Hotel "Xheko Imperial" në Tiranë tryezën e rrumbullakët me temë: "Eksperienca sllovene në tregun e sigurimeve".

Pjesëmarrës në këtë event ishin përfaqësues të tregut të sigurimeve, të tregut bankar dhe atij të mikrofinancës, të shoqatave të bujqësisë dhe turizmit, etj.

E ftuar në këtë takim, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zj.Sonila Qato vlerësoi iniciativën e tregut të sigurimeve dhe garanto mbështetjen e qeverisë dhe të dikasterit që ajo drejton për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të këtij tregu.

Në përshëndetjen e tij, z.Pajtim Melani- Kryetari i Bordit të AMF-së vlerësoi bashkëpunimin e nisur me një nga tregjet më të zhvilluara në rajon dhe shprehu bindjen se ky takim përbën një hap të sigurtë drejt zgjerimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të këtij tregu.

Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës Sllovene të Sigurimeve - Zj.Maja Krumberger dhe koleget e saj sollën përvojën e tregut slloven në fushën e sigurimeve, duke u ndalur veçanërisht ne aspekte të veçanta të tij siç janë sigurimet në bujqësi, në turizëm dhe në shëndetësi.

Të pranishmit në këtë takim diskutuan me përfaqësuesit e tregut slloven për çështje të veçanta që shqetësojnë sot tregun e sigurimeve, nëpërmjet debateve dhe shkëmbimit të eksperiencave respektive.

Shoqata e Sigurimeve të Shqipërisë dhe Shoqata Sllovene e Sigurimeve nënshkruan dhe Memorandumin e Bashkëpunimit, çka zyrtarizon edhe fillimin e një bashkëpunimi afatgjatë mes dy shoqatave, si përfaqësuese legjitime të shoqërive të sigurimit që veprojnë në tregjet përkatëse.



ZHVILLON PUNIMET FORUMI ME TEMË "EDUKIMI FINANCIAR PËR PËRFSHIRJEN FINANCIARE"



Në datën 29 qershor 2018, në Tiranë, zhvilloi punimet forumi me temë "Edukimi financiar për përfshirjen financiare". Kjo veprimtari u organizua nga Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), Shoqatës së Tregëtimit të Titujve në Shqipëri (ASTA) dhe Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës (AMA). Në këtë forum, pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucioneve të tjera publike, shoqata të ndryshme, organizata jo - fitimprurëse, rrethe akademike në vend, përfaqësues të sektorit bankar e financiar, përfaqësues të medias, etj.

Gjatë punimeve të forumit, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të një Memorandumi Bashkëpunimi, ndërmjet Shoqatës Shqiptare të Bankave, Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës, Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve, Shoqatës së Tregëtimit të Titujve në Shqipëri, Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, Junior Achievement of Albania, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Shërbimit Kombëtar për Rininë.

Në emër të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë Memorandumi u nënshkrua nga zj. Fitnete Sulaj - Kryetare e kësaj shoqate.

Ky memorandum synon krijimin e Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar dhe rritjen e bashkëpunimit dhe e koordinimit ndër-institucional në fushën e edukimit financiar.

STAFI I SIGMA INTERALBANIAN VIG DHURON GJAK PËR FËMIJËT TALASEMIKË.

Muaji Qershor është muaji i Dhurimit të Gjakut për fëmijët talasemikë, ndaj stafi i Sigma Inter Albanian VIG nën moton: "Dhurojmë gjak, shpëtojmë jetë!", vendosi të bëhet pjesë e kësaj nisme. Në bashkëpunim me shoqatën e Transfuzionit të gjakut si dhe "Fundjavë ndryshe", u ngrit në ambientet e Zyrave Qendrore të kompanisë një kënd i vogël por i përshtatshëm për të kryer ekzaminimet e nevojshme paraprake si dhe procesin e dhurimit të gjakut. Dhurimi i gjakut është një akt vullnetar, pa shpërblim dhe është shumë i rëndësishëm për atë që e ka nevojë jetike. Gjaku nuk mund të prodhohet në laborator, prandaj burimi i vetëm për të diagnostikuarit me talasemi është dhurimi i tij. Ishte një kontribut i vogël nga stafi i kompanisë tonë, por kënaqësia që mund të ndikosh në përmirësimin e jetës së një fëmije ishte shumë e madhe.



ZHVILLIMET KRYESORE TË TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR - MAJ 2018

- Në janar - maj 2018 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 3.01%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 183,634 mijë lekë duke arritur shifrën 6,277,101 mijë lekë.
- Numri i kontratave arriti në 462,260 duke shënuar një rritje me 7.30 % krahasuar me janar - maj 2017.
- Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 5,838,951 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 3.62% krahasuar me janar- maj 2017.
- Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 410,335 duke shënuar një rritje në masën 8.48% krahasuar me janar - maj 2017.
- Gjatë janar -maj 2018, janë paguar gjithsej 1,940,144 mijë lekë dëme ose 17.57% më pak se gjatë periudhës janar-maj 2017.
- Numri i dëmeve të paguara në janar - maj 2018 është ulur me 3,759 dhe arriti shifrën 17,722 nga të cilat 17,003 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 719 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

ZHVILLOHET NE TIRANE "UNIQA INTERNATIONAL FORUM 2018".



Nën sloganin "Mendo që idetë e mëdha ndriçojnë rrugën", në datat 4-8 qershor 2018 në Tiranë, zhvilloi punimet Forumi Ndërkombëtar Ekonomik "UNIQA International Forum 2018".

Me ftesë të SIGAL UNIQA Albania dhe nën kujdesin e veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Avni Ponari, mbi 120 CEO dhe Kryetarë të Bordeve Drejtuese të kompanive UNIQA Insurance Group nga 16 shtete Europiane u mblodhën në Tiranë për të diskutuar mbi mbarëvajtjen, objektivat dhe synimet e grupit UNIQA në të gjithë shtetet ku gjigandi europian i sigurimeve operon, përfshirë edhe Shqipërinë nëpërmjet SIGAL UNIQA Group Austria.

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Erion Veliaj u uroi mirëseardhjen të ftuarëve në Tiranë, dhe duke folur për potencialin e jashtëzakonshëm që ka Tirana dhe e gjithë Shqipëria, gjithashtu u ndal në rolin që ka luajtur SIGAL UNIQA në zhvillimin ekonomik dhe përgjegjësinë sociale të Tiranës dhe më gjerë.

Në përfundim të Forumit, Z. Ponari, si pritës i mysafirëve europianë, i ftoi ata që të vizitojnë sërish bukuritë e ralla të Shqipërisë.

ANËTARËT E SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË

